

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 22
24.10.2014

NR. VENDIMI 20
25.10.2014

VENDIM

“Per zgjatjen e aftatit te sekuestros”

Gjykata e Shkalles se Pare
per Krime te Renda Tirane e perbere prej:

Gjyqtare : Iliriana OLLDASHI

Asistuar nga sekretarja gjyqesore **Ankela Dake**, sot ne daten **25/10/2014, ora 12.06 ne Tirane**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore kerkesen me **nr. 22 rregjistri** qe i perket:

Kerkues: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, **perfaqesuar ne gjykim nga prokurori Ened NAKUÇI.**

Me objekt: I. Zgjatjen e aftatit te sekuestros te caktuar me vendimin nr.xx date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda, te zgjatur me vendimet nr.xx date xxx dhe nr.xx date xxx per nje peridhe tre mujore per shumat bankare si me poshte vijon:

- a) shumat ne depoziten e kursimit me gjendje xxx (xxx) EURO, e cila lidhet me llogarine me nr.xxx qe i perkasin shtetases A.Ll. S. e dtl.xxx.
- b) Shumat ne depoziten e kursimit me gjendje aktuale xxx (xxx) USD, e cila lidhet me llogarine me nr.xxx e cila

i perket klientes A.L.L.S. e dtl.xxx.

- I. Per Administrimin dhe perdorimin e pasurive te luajtshme dhe paluatshme te ngarkohet z.S.M., i cili eshte administrator i Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.
- II. Per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohet Zyra e Perambarimit xxx.

Kunder: K. (L.) B., i biri i M. dhe i N., datelindja xxx, banues ne xxx, Lagjia “xxx”.

Person i trete: A.S., e bija e Ll. dhe e S., e datelindjes, xxx, lindur ne xxx, xxx dhe banuese ne xxx.

Baza ligjore:Ligji nr. 10192 date 03/12/2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”.

Ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses te zhvilluar ne prani te prokurorit Ened Nakuçi qe kerkoi: pranimin e kerkeses, kjo gjykate pasi degjoi kerkimet dhe shqyrtoi aktet e paraqitura:

VEREN se :

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, ka paraqitur para kesaj gjykate nje kerkese per zgjatjen e afatit te sekuestrimit te vendosur nga kjo gjykate me vendimin e saj nr. 10, date 11/11/2013 per pasurite qe i perkasin shtetases A.L.L.S., dhe zgjatur ky afat me vendimet nr.xx date xxx dhe nr.xx date xxx te po kesaj gjykate.

Nje kerkese te tille, prokurori e ben ne mbeshtetje te nenit 12/3 te **Ligji nr. 10192 date 03/12/2009** “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise” dhe parashtimit te ketyre fakteve:

Kerkesen prokurori e paraqet duke ju referuar ketyre fakteve:

“Me shkresen Nr.xxx date xxx Drejtoria e Policise xxx ka derguar materialet duke referuar fillimin e procedimit pasuror ndaj shtetasit K.(L.) B., pasi me date xxx eshte arrestuar nga Sherbimet e Policise Gjyqesore xxx per vepren penale te “Trafikimit te lendeve narkotike" pasi se bashku me nje shtetas xxx jane kapur ne flagrance me xxx gram heroine si dhe xxx Euro. Gjithashtu nga hetimi ka rezultuar se me daten xxx eshte realizuar ndryshimi i emrit ne zyren e gjendjes civile xxx nga L. ne K..

Gjate hetimit nga Drejtoria e Policise se Qarkut xxx ne bashkepunim me DPPPP per kete shtetas dhe familjare te tij rezulton te kene kryer transaksione ne vlera te konsiderueshme te dyshimta.

Ne lidhje me kete fakt, **Prokuroria e rrethit Gjyqesore xxx** ka rregjistruar procedimin penal **Nr.xxx date xxx** per vepren penale te " Pastrimit te produkteve te vepres penale " parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Per kete shtetas jane kryer verifikimeve dhe veprime hetimore;

Me shkresat Nr. xxx date xxx, dhe Nr. xx date xxx, eshte kerkuar dosja hetimore nga prokuroria xxx e cila me shkresen xxx date xxx, ka vene ne dispozicion pjesisht dosjen hetimore Nr xxx viti xxx dhe me shkresen Nr. xxx date xxx, ka vene ne dispozicion dosjen Nr. xxx te vitit xxx duke sqaruar se procedimi penal eshte rifilluar pas administrimit te akteve te leterporosise nga Autoritetet Gjyqesore xxx dhe po kryhen hetime.

Ne kushtet kur ky shtetas hetohej ne shtetin grek per vepren penale te “Prodhimit dhe shitjes se narkotikeve” ne bashkepunim me nje shtetas xxx, veper kjo qe parashikohet dhe nga Kodi Penal ne nenin 283/2 te tij, ne baze te nenit 3 pika « ç » shtetasi K. (L.) B. dhe familjaret e tij jane subjekte te hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe Trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”. Per kete shtetas familjaret e tij jane kryer verifikimet pasurore.

Nga hetimi ka rezultuar se i hetuari K. (L.) B. dhe familjaret e tij, nuk disponojne te ardhura te ligjshme qe te justifikojne vlerat monetare dhe pasurine e paluajtshme, por keto pasuri dyshohet se jane krijuar si rezultat i aktivitetit te paligjshem ne fushen shitjes se lendeve narkotike.

Me vendimin nr. xx date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, eshte pranuar kerkesa e Prokurorise per Krime te Renda duke u vendosur:

1- Sekuestrimin prane **xxx Bank** te shumave ne depoziten e kursimit me gjendje **xxx (xxx) EURO**, e cila maturohet ne date xxx, e cila lidhet me llogarine me nr.xxx qe i perkasin shtetases A.LI.S. e dtl.xxx.

2- Sekuestrimin prane **xxx Bank** te shumave ne depoziten e kursimit me gjendje aktuale **xxx (xxx) USD**, e cila lidhet me llogarine me nr.xxx e cila i perket klientes A.LI.S. e dtl.xxx.

Kjo sekuestro e vendosur sipas parashikimit te nenit 12/2 te **Ligjit nr. 10192 date 03/12/2009** eshte e vlefshme per nje periudhe gjashte-mujore duke filluar nga momenti i zbatimit te saj.

Me shkresen nr. xxx, date xxx te Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara, konfirmohet fakti se vendimi i sekuestros eshte zbatuar me date xxx nga administratori i caktuar nga gjykata z. V.P. dhe afati i vlefshmerise se kesaj sekuestroje ka perfunduar ne daten xxx.

Kjo gjykate, mbi bazen e kerkesave te organit te prokurorise, me vendimet nr.xx date xxx dhe nr.xx date xxx, ka zgjatur per dy periudha tre-mujore afatin e sekuestros te vendosur sa me siper.

Gjithashtu nga ana e perfaqsesit ligjor te shtetases A.S. jane paraqitur disa memorie prane Prokurorise per Krime te Renda, konkretisht date xxx, date xxx, xxx, dhe xxx, ne te cilat jane depozituar nje material i plotesuar me kopje te njesuara me origjinalin te 16 librezave te kursimit te familjareve te shtetases A.S. ne xxx, akte te familjareve te kesaj te fundit ne xxx, akte qe kane te bejne me pagimin e siguracioneve te kesaj shtetaseje ne xxxdhe akte te tjera te transaksioneve te kasaj te fundit dhe familjareve te saj te realizuara ne xxx.

Per te gjykuar lidhur me vleren e ketyre akteve te paraqitura nga mbrojtja nga ana e prokurorise u çmua e nevojshme kryerja e nje ekspertimi kontabel nga ana e nje eksperti i cili te beje te mundur te nxjerre levizjen e fondeve nga llogarite e ndryshme per te sa mbrojttesi pretendon.

Per nje hetim te plote e te gjithanshem te ketij procedimi pasuror, me qellim marrjen e nje konkluzioni te sakte dhe duke qene se kerkohen njohuri nga specialiste te fushes perkatese, bazuar dhe ne nenet 178, 179 dhe 182 te K.Pr.Penale, nga ana e organit procedues ne daten xxx eshte urdheruar kryerja e ekspertimit kontabel ku eksperti duhet t'i pergjigjet pyetjeve te meposhtme:

- Te percaktohet se cilat jane te ardhurat te depozituara nga shtetasja A.S. dhe familjaret e saj ne vite duke u bazuar ne dokumentacionin e dorezuar prej saj dhe atij qe ndodhet ne fashikullin e procedimit pasuror si dhe cila eshte levizja e ketyre depozitave nga njera banke ne tjetren nder vite.
- Nese eshte e mundur te percaktohet dhe burimi i ketyre te ardhurave nga informacioni i paraqitur ne institucionet bankare.

Per perfundimin e veprimeve per hetimin pasuror, organi i prokurorise çmon se eshte e nevojshme perfundimi i ekspertimit kontabel si dhe kryerja e veprimeve te tjera qe kane te bejne me ekzekutimin e vendimit nr.xx date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda mbi sekuestrimin e pasurise prone e paluajtshme te llojit toke are me sipërfaqe xxx m² me numer pasurie nr.xxx, Zk.xxx, Vol.x, fq.xx are me sipërfaqe xxx m² me reference xxx, xxx, ndodhur ne xxx xxx ne emer te K.M.B. blere ne date xxx.

Duke qene se afati tre-mujor i zgjatjes se sekuestros perfundon ne daten xxx, prokurori i eshte drejtuar kesaj gjykate me kerkese per zgjatjen e afatit te sekuestrimit edhe per nje periudhe tre mujore.

Per kete arsye, prokurori vlereson se eshte e nevojshme qe per sekuestron e llogarive te shtetases A.S. te behet dhe nje zgjatje tjeter e afatit te sekuestros per nje peridhe tre mujore ne baze te nenit 12/3 te ligjit nr. 10192 date 03.12.2009 "Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise".

Gjykata vlereson se duhet te pranoje kerkesen e Prokurorise per Krime te Renda per zgjatjen e afatit te vlefshmerise se sekuestros, mbi keto argumenta:

Prokuroria ka kerkuar kohe per perfundimin e ekspertimit kontabel si dhe per ekzekutimin e vendimit nr. xx date xxx te kesaj gjykate, per sekuestrimin e pasurive te paluajtshme te ne emer te shtetasit K.M.B.

Duke patur parasysht kerkesat e nenit 12/3 te Ligjit nr. 10192 date 03/12/2009, gjykata i vlereson si argumenta te mjaftueshme ato te dhena nga Prokuroria Per Krime te Renda, per t'u konsideruar verifikime komplekse per hetimin pasuror.

Mbi kete baze, me kerkese te pales paditese vendos zgjatjen e afatit te zbatimit te sekuestros se caktuar prej saj me vendimin nr. xx date xxx, zgjatur ky afat me vendimet nr.xx date xxx per nje periudhe tre-mujore si dhe me vendimin nr.xx date xxx per nje periudhe –tre-mujore, duke e zgjatur ate per nje periudhe tjeter prej tre-muajsh.

Mbi arsyetimin e pasqyruar me siper, ne baze te nenit 12 ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”, kjo gjykate pasi formoi bindjen dhe ne mbeshtetje te provave te shqyrtuara ne kete gjykim:

VENDOSI

Pranimin e kerkeses

Zgjatjen e afatit te sekuestros te caktuar me vendimin nr.xx date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda dhe zgjatur ky afat me vendimet nr.xx date xxx dhe nr.xx date xxx te kesaj gjykate, per nje peridhe tre mujore per shumat bankare si me poshte vijon:

a) shumat ne depoziten e kursimit me gjendje xxx (xxx) EURO, e cila lidhet me llogarine me nr.xxx qe i perkasin shtetases A.Ll.S. e dtl.xxx.

b) Shumat ne depoziten e kursimit me gjendje aktuale xxx (xxx) USD, e cila lidhet me llogarine me nr.xxx e cila i perket klientes A.Ll.S. e dtl.xxx.

I. Per Administrimin dhe perdorimin e pasurive te luajtshme dhe paluatshme te ngarkohet z.S.M., i cili eshte administrator i Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

II. Per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohet Zyra e Permbarimit xxx.

Urdherohet sekretaria gjyqesore e kesaj gjykate te dergoje menjehere kopje te ketij vendimi ne institucionet e mesiperme si dhe per njoftimin e

zoteruesve te pasurive **K. (L.) B.** dhe **A.S.**, ne adresat e banimit, ose qendrimit te tyre te tyre.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda brenda afatit ligjor.

U shpall sot ne Tirane, me date 25/10/2014, ora 12.22.

Sekretare

Ankela DAKE

Gjyqtare

Iliriana OLLDASHI